VENDIM
Nr. 596, datë 31.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS "XOXI ANDONI" DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", FIER

(Ndryshuar me VKM nr. 123, datë 3.3.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. .Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugës "Xoxi Andoni" dhe hapësirave rreth saj", Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 138 248 315 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 138 248 315 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë të përballohet:

- 137 500 521 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë e pesëqind e njëzet e një) lekë, nga llogaria "Fondi i shpronësimeve";

- 747 794 (shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Bashkinë Fier.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS XOXI ANDONI DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", FIER

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. përgj. truallit (m²)	Sip. prekur truallit (m²)	Çmimi për truallin (lekë/ m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale ndërtesës me certifikatë (m²)	Sip. prekur ndërtesës (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Ardian Abedin Kucukali & Viktor Llambi Cuko	8534	3/86-ND	-	-	12,893	0	110.5	110.5	30%	1,289,194	1,289,194	Plotësim dokumentacioni
2	Liri Demishaj	8534	3/457	56.5	56.5	12,893	728,455	56.5	56.5	5%	1,253,046	1,981,501	Plotësim dokumentacioni
3	Merjeme Boriçi (Dizdari) + 9 bashkëpronarë	8534	3/45	3,234	3,234.0	12,893	41,695,962	1,922.0	935.0	75%	2,983,196	44,679,158	Plotësim dokumentacioni
4	Fatbardha Shefit Arapi	8534	3/370	66.0	66.0	12,893	850,938	35.0	35.0	40%	636,624	1,487,562	Plotësim dokumentacioni
5	Bujar Gani Tahiraj	8534	3/447	362.0	362.0	12,893	4,667,266	120.0	120.0	3%	4,293,347	8,960,613	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 12.8.2015
6	Ylvi Sulejman Sulejmani	8534	3/112-D	-	-	-	0	10.5	10.5	3%	654,335	654,335	Plotësim dokumentacioni
7	Nuredin Myslym Isufaj	8534	3/223	106.6	106.6	12,893	1,374,394	78.0	78.0	20%	1,433,200	2,807,594	Inskriptuar në favor të Banks FEFAD, plotësim dokumentacioni
8	Brisilda Karafilaj & Geno Karafilaj	8534	3/371	134.0	134.0	12,893	1,727,662	45.0	45.0	40%	740,377	2,468,039	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 12.8.2015
9	Lindita Ajasllari	8534	3/455	58.2	58.2	12,893	750,373	58.2	58.2	5%	1,290,748	2,041,121	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 12.8.2015
10	Luljeta Zeqo & Xhezmie Zeqo	8534	3/65-N7	-	-	-	0	43.6	43.6	30%	611,746	611,746	Plotësim dokumentacioni
11	Artan Pelari & Liri Peshku & Matilda Pelari & Vangjel Peshku	8534	3/65-N8	-	-	-	0	16.1	16.1	30%	225,897	225,897	Plotësim dokumentacioni
12	Artan Pelari & Liri Peshku & Matilda Pelari & Vangjel Peshku	8534	3/65-N9	-	-	-	0	15.7	15.7	30%	220,285	220,285	Plotësim dokumentacioni
13	Artan Pelari & Liri Peshku & Matilda Pelari & Vangjel Peshku	8534	3/464	33.2	33.2	12,893	428,048	33.2	33.2	5%	736,303	1,164,351	Plotësim dokumentacioni
14	Artan Pelari & Liri Peshku & Matilda Pelari & Vangjel Peshku	8534	3/465	32.6	32.6	12,893	420,312	32.6	32.6	5%	722,996	1,143,308	Plotësim dokumentacioni
15	Rifat Puto + Bashkëpronarët sipas certifikatës së pronësisë	8534	3/268	2,304.4	2,304.4	12,893	29,710,629	258.0	258.0	60% & 70%	4,453,119	34,163,748	Konfirmimi për këtë pronë është bërë nga ZVRPP-ja në datën 12.08.2015 por në konfirmimin e ZVRPP-së në datën 8.6.2016 rezulton se pasuria 3/268 është e regjistruar në emër të z. Pandi Allabashi dhe 71 bashkëpronarë. Plotësim dokumentacioni
16	Pajtim Beqir Nure	8534	3/448	680.0	680.0	12,893	8,767,240	-	-	-	0	8,767,240	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 8.6.2016
17	Lindita Borici + 9 bashkëpronarë	8534	3/261	1,788.25	1,788.25	12,893	23,055,907	-	-	-	0	23,055,907	Plotësim dokumentacioni
18	Sabri Mylsym Isufaj	8534	3/184	68.0	68.0	12,893	876,724	-	-	-	0	876,724	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 8.6.2016
19	Luftar Myqerem Gjeli	8534	3/258	25.0	25.0	12,893	322,325	-	-	-	0	322,325	Konfirmim nga ZVRPP-ja në datën 8.6.2016
20	Mitat Ismail Rrapaj & Fejzi Mystehak Hoxha	8534	3/197	18.0	18.0	12,893	232,074	18.0	18.0	30%	347,800	579,874	Pasuria ka barrë hipotekore. Plotësim dokumentacioni
											Vlera totale	**137,500,521**	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar në VKM nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"

(Shtuar me VKM nr. 123, datë 3.3.2021)

LISTA E VLERËSIMIT TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS 'XOXI ANDONI' DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", SHTESA FIER

Shënim. Çmimi për tokën "truall" është marrë në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kad.	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e objektit të banimit (m^2)	Sip. e truallit (m^2)	Çmimi i objektit të banimit (l/m^2)	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Konfirmim nga ZVRPP-ja
21	Xhelo Sinan Xhuveli	ZK. 8534	3/205	Fier	___	58	___	12,893.00	___	747.794	747.794	Konfirmuar nga ZVRPP-ja.
	VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT						**747,794.00**					